



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/83
Datë: 11.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Administrimit të Resurseve Ujore.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Koncept dokumenti Në Fushën e Administrimit të Resurseve Ujore

Prishtinë, 2017

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Kapitulli I – Hyrje

Kërkesat e dokumenteve politike për avancim në administrimin e resurseve ujore si Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Strategjia për ndryshime klimatike 2014-2024, Strategjia për Ujërat e Kosovës 2015 – 2034, si në aspektin e gjendjes së resurseve ujore e po ashtu edhe anës rregullative ligjore bëjnë të domosdoshme nevojën e plotësimit-ndryshimit të Ligjit të Ujërave. Gjithashtu, Plani Legjislativ i Qeverisë 2017 në mënyrë të drejtpërdrejtë autorizon hartimin e këtij koncept dokumenti, përmes të cilit do të i ofrohet mbështetje për vendimmarrje Qeverisë për aprovim të ndryshim-plotësimit të Ligjit për Ujëra në harmoni me Rregulloren e Punës për Qeverinë e Republikës së Kosovës Nr. 09/2011

Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik dhe ngritja e standardeve të jetës shton kërkesën për ujë .Kosova ka resurse të pamjaftueshme ujore, dhe në të ardhmen do të jetë faktorë kufizues për zhvillim ekonomik dhe social të vendit [Strategjia Shtetërore e Ujërave 2015-2034]. Është vlerësuar se Kosova ka vetëm 1,600 m³ ujë/Vit për banor. Andaj, në vazhden e këtyre kundërthënieve është e pamundur të paramendohet një zhvillim ekonomik pa menaxhimin adekuat të resurseve ujore. Pra, në rrethana të reja të konstatimeve të Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës 2015-2034 dhe konsideratës së konstatimeve të Strategjisë për ndryshime klimatike 2014-2024, krahas riprioritizimit në sektorin e ujërave në nivel të politikave Qeveritare , gjendja faktike prioritetizon edhe ndryshimin e legjislacionit të ujërave në tërësi e me theks të veçantë Ligjin për Ujëra .

Gjithashtu, çështja e ndryshimit të Ligjit për Ujëra është imperativ i domosdoshëm dhe ndërlikohet drejtpërdrejt me nevoja imediate të plotësimit-ndryshimit të Ligjit në aspektin e dispozitave për çështje rregullative të pronave, financave dhe të së drejtës ujore. Krejt kjo ,pasi legjislacioni aktual nuk definon afatet kohore të Akteve Ujore (Kushteve ujore dhe Pëlqimit Ujorë),pastaj ligji në fuqi nuk rregullon plotësisht procedurat e regjistrimit të pronave ujore dhe ato të procedurave llogaritare të tarifave ujore.

Konstatimi i Raportit të Gjendjes së Ujërave 2015 , përafrimi i legjislacionit me ‘acquis communautaire’ dhe ratifikimi i konventave të BE-së është nën nivelin e 50% si dhe zotimet e Kosovës sipas MSA-së në anën tjetër, bëjnë çështje imediate ndryshim-plotësimit të legjislacionit të ujërave e me theks të veçantë Ligjin e Ujërave.Gjithashtu, krahas konstatimeve të paragrafeve paraprak lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit të ujërave edhe Strategjia e Ndryshimeve Klimatike drejt për drejtë kërkon hartim të legjislacionit për transportin e ujit nga një pellg lumor në pellgun tjetër lumor.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor Shpjegimi

Korniza ekzistuese ligjore , përfshirë Ligjin për Ujërat e Kosovës dhe aktet përkatëse nënligjore në fushën e rregullimit të së drejtës ujore, rregullimit të çështjes së pronave dhe atë të çështjes së financave nuk kanë dhënë deri më tani rezultatet e pritura andaj rezulton si i domosdoshëm ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit të ujrave-Ligjit të Ujërave.

Problematika e administrimit të resurseve ujore përmes instrumenteve të akteve ujore (Kushteve ujore, Pelqimit Ujor dhe Lejes jore), të cilave me Ligjin aktual nuk u është përcaktuar në mënyrë eksplicite afati i vlefshmerisë kohore, ka sjellur kompleksitet në procesin administrativ të lëshimit të Kushteve Ujore dhe Pelqimeve Ujore për ndërtimin e hidrocentraleve. Në disa raste në mungesë të përcaktimit të afatit të vlefshmërisë së vendimit të Kushteve Ujore për hidrocentrale të vogla, është prolonguar procesi deri te leja ujore, duke prolonguar kështu dinamikën e realizimit të planit të Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla.

Problematikë relevante e Ligjit aktual është edhe mungesa e dispozitave kalimtare të cilat përcaktojnë mënyrën e administrimit të resurseve ujore në mungesë të Strategjisë Shtetërore të Ujërave dhe Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore të cilat nuk janë hartuar ende, përderisa dokumentet planare paraprake (Baza Hidroekonomisë 1983-2003) nuk janë në fuqi nga viti 2003. Plotësimi me dispozita përkatëse të Ligjit të Ujërave lidhur me çështjen e aplikimit të dokumenteve planare do të përcaktonte bazën ligjore të menaxhimit me resurse ujore deri në hartimin e dokumenteve planifikuese obligativo-ligjore.

Mungesa e dispozitave të mjaftueshme në Ligjin aktual, si në aspektin e regjistrimit të pronave ujore prej mijëra hektarëve (sipërfaqet ujore të destinuara për regjim ujor) dhe në atë të së drejtës së dhënjes në shfrytëzim nga palët e interesuara, ka sjellur dëme të konsiderueshme në të hyrat financiare nga shfrytëzimi i resurseve ujore. Gjithashtu vlenë të theksohet se Ligji aktual nuk ka përcaktuar as një aktë nënligjor lidhur me rregullimin juridik të çështjeve të pronave ujore.

Menaxhimi i resurseve ujore krahas aspektit mjedisor (mbrojtja e ujërave) është në vete edhe ekonomi ujore, nga ekonomizimi i resurseve , përmes tarifave të shfrytëzimit dhe shkarkimit të ujërave , domosdo do të duhej realizuar të hyra buxhetore në vlera prej disa miliona euro në vit nga tarifat ujore. Mos arritjeve në inkasimin e tarifave ujore në nivelin e duhur krahas mos-arritjeve të zbatimit të Ligjit u ka kontribuar edhe mungesa e dispozitave adekuate ligjore në aspektin e metodologjisë së përlllogaritjes së sasive ujore në rastet kur operatorët nuk masin ujërat me pajisje matëse ose nuk raportojnë.

Përafrimi me legjislacionin dhe standardet e BE-së, gjegjësisht transpozimi idirektivave për fushën e ujërave është objektiv kryesor i përcaktuar në Strategjinë Shtetërore të Ujërave 2017-2034 [Objektivi i akterit kryesor i SSHU], dhe obligimet për përmbushjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) që ka Kosova.

1. Politikat aktuale

Zbatimi i politikave aktuale në mungesë të dokumenteve planifikuese ligjore është i bazuar në Ligjin aktual të ujrave dhe akteve nënligjore të dala nga Ligji. Sipas Ligjit gjithsej janë 17 UA prej të cilave 15 janë në zbatim, derisa 2 janë para miratimit për herë të parë.

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE –Ligji INr.04/L-147 për UJËRAT E KOSOVËS
Të miratuara:

1. Udhëzimi Administrativ 63/05 mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrën e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore;
2. Udhëzim Administrativ 26/2013 për Përcaktimin e Mënyrës së Evidentimit dhe Formën e Legjitimacionit të Inspektoratit për Ujëra;
3. Udhëzim Administrativ 12/2013 për Sistemin Informativ Ujorë;
4. Udhëzim Administrativ 28/2014 për Zonat e Mbrojtura Sanitare;
5. Udhëzim Administrativ 30/2014 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujorë;
6. Udhëzim Administrativ 20/2015 për Zonat për Larje;
7. Udhëzim Administrativ 12/2015 për Përcaktimin e Kritereve për Zonat e Mbrojtura për Qëllime Strategjike;
8. Udhëzim Administrativ 19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave;
9. Udhëzimi Administrativ 02/2016 për Strukturën e Pagesave të Ujit;
10. Udhëzim Administrativ 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore;
11. Draft Rregullorja 02/2016 për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike;
12. Udhëzim Administrativ 11/2016 për Përcaktimin e Masave dhe Veprimeve për Mbrojtje nga Erozioni;
13. Udhëzim Administrativ 04-2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujë rrjedhave dhe Akumulacioneve;
14. Udhëzim Administrativ 09/2016 për Strukturën Organizative dhe Detyrat shtesë të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore
15. Udhëzim Administrativ për projektimin , ndërtimin dhe shfrytëzimin e Digave Nr. 09 / 2017

Në procedurë:

1. Udhëzim Administrativ për Klasifikimin e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë(pritet të kryhet në K-2 /2017);
2. Udhëzim Administrativ për Klasifikimin e Trupave Ujorë Nëntokësorë(pritet të kryhet në K-2 /2017);

Legjislacioni kombëtar ekzistues që rregullon procedurat e Administrimit të resurseve ujore që kanë një ndikim të rëndësishëm në mjedis dhe shëndeti publik, gjerë me tani kanë transpozuar pjesërisht një pjesë të legjislacionit përkatës mjedisor të BE-së (Shihni listën e plotë të ligjit relevant të BE-së në paragrafin Politika Aktuale - legjislacioni i BE-së)

Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 23 tetor 2000 për krijimin e një kornize për veprimin e Komunitetit në fushën e politikave të ujërave, ndryshuar e plotësuar me Vendimin 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU si dhe Direktivën e Komisionit 2014/101/EU (Direktiva Kornizë e Ujërave)

Direktiva e Këshillit 91/271/EEC e datës 21 maj 1991 në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza urbane, ndryshuar e plotësuar me Direktivën 98/15/EC dhe Rregulloren (EC) 1882/2003 dhe Rregulloren (EC) 1137/2008 (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane) – Vendimi implementues i Komisionit i datës 26 qershor 2014 në lidhje me formatet e raportimit mbi programet shtetërore për zbatimin e Direktivës së Këshillit 91/271/EEC (2014/431/EU)

Direktiva e Këshillit 98/83/EC e datës 3 nëntor 1998 për cilësinë e ujit që përdoret për konsum njerëzor, ndryshuar e plotësuar me Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009 dhe Direktivën e Komisionit (EU) 2015/1787 (Direktiva për Ujin e Pijes) – Vendimi i Komisionit 95/337/EC në lidhje me pyetësorët që kanë të bëjnë me Direktivën në sektorin e ujit

Direktiva e Këshillit 91/676/EEC e datës 12 dhjetor 1991 në lidhje me mbrojtjen e ujërave nga ndotja që shkaktohet nga nitratat nga burimet bujqësore, ndryshuar e plotësuar me Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008 (Direktiva e Nitrates)

Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 15 shkurt 2006 në lidhje me menaxhimin e cilësisë së ujit për larje, si dhe që shfuqizon Direktivën 76/160/EEC, ndryshuar e plotësuar me Rregulloren (EC) 596/2009 dhe Direktivën 2013/64/EU (Direktiva për Ujin e Larjes)

Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 dhjetor 2006 mbi mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi (Direktiva për ujërat nëntokësore)

Direktiva 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 16 dhjetor 2008 për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave të ujit, që ndryshon e rrjedhimisht shfuqizon Direktivat e Këshillit 82/176/EEC, 83/513/EEC, 84/156/EEC, 84/491/EEC, 86/280/EEC si dhe ndryshon Direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, ndryshuar e plotësuar me Direktivën 2013/39/EU në lidhje me substancat prioritare në fushën e politikave ujore (Direktiva e Standardeve të Cilësisë së Mjedisit)

Direktiva e Komisionit 2009/90/EC e datës 31 korrik 2009 që cakton, në pajtim me Direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, specifikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin e statusit të ujërave (Direktiva e Sigurimit të Cilësisë/Kontrollit të Cilësisë)

Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 tetor 2007 për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga vërshimet (Direktiva e Vërshimeve)

Për shkak të këtyre ndryshimeve në legjislacionin e BE-së dhe duke marrë parasysh:

- MSA dhe në veçanti Nenet 115 dhe 116 mbi "Mjedisin" dhe "Ndryshimet Klimatike" duhet të marrin parasysh kushtet që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me acqin e BE-së.
- Objektivat dhe aktivitetet e MMPH në Planin Vjetor të Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017¹.

LEGJISLACIONI I KOSOVËS

Implementimi i Ligjit të Ujërave Nr.04/L-147 në Kosovë filloi në vitin 2013.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet të cilat ndërlidhen me këtë problem/çështje/:

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosoves

Qëllimi i këtij ligji është:

2.1. të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës;

2.2. të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin;

2.3. të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi;

2.4. të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore.

¹ Objektivi 1 - Përmirësimi i gjendjes së mjedisit, Aktiviteti 1.1 Përmirësimi i procesit të procedurave administrative për lëshimin e Lejes së Integruar të Mjedisit

Ligji Nr. 03/L-198 për ndryshimin dhe plotesimin e ligjit Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore

Ky Ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore për themelimin dhe funksionimin e subjekteve që afrojnë shërbime dhe shfrytëzuesve të shërbimeve dhe organizimin e mirëfilltë të tyre në mënyrë që të krijohen kushtet optimale për ujitjen e tokës bujqësore në Kosovë dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve të prodhimeve bujqësore.

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

1. Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.

Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes,

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes i cili vjen si pasojë e veprimtarive të paraqitura në Aneksin 1. të këtij ligji, në veçanti duke parandaluar dhe reduktuar mbeturinat, emisionet në ajër, ujë dhe tokë.

Ligji Nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit,

Me këtë ligj rregullohen parimet, organizimi dhe mbikëqyrja inspektuese, koordinimi i mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedura për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

Ligji Nr. 03/L-230, për Vlerësimin Strategjik Mjedisor,

Qëllimi i këtij ligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Ligji Nr. 04/L -060. për Mbeturinat,

1.0 Ky ligj ka për qëllim:

- 1.1. evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave;
- 1.2. ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat;
- 1.3. zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore;
- 1.4. parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
- 1.5. deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Aktet nënligjor të cilat ndërlidhen me këtë problem/çështje/:

Udhëzimi Administrativ Nr. 63/05 mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrën e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore;

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet përmbajtja, forma, kushtet dhe mënyra e lëshuarjes së lejes ujore, afatet e ruajtjes së saj si dhe çështjet tjera me rëndësi për lëshuarjen e lejes ujore.

Udhëzim Administrativ Nr. 26/2013 për Përcaktimin e Mënyrës së Evidentimit dhe Formën e Legjitimacionit të Inspektoratit për Ujëra;

Ky Udhëzim Administrativ përcakton legjitimacionin në mënyrë të veçant për inspektorin e ujerave.

Udhëzim Administrativ Nr. 12/2013 për Sistemin Informativ Ujorë;

Me këtë akt nënligjor rregullohen masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me regjistrimin, shfrytëzimin, transferimin dhe mbrojtjen e të dhënave si dhe çështjet tjera me rëndësi për administrimin e ujerave.

Udhëzim Administrativ Nr. 28/2014 për Zonat e Mbrojtura Sanitare;

Me këtë udhëzim administrativ caktohen zonat e mbrojtura sanitare, kriteret dhe masat për mbrojtjen e burimeve të ujit të cilat shfrytëzohen dhe mund të shfrytëzohen në të ardhmen për furnizimin me ujë të popullsisë.

Udhëzim Administrativ Nr. 30/2014 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujorë;

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura.

Udhëzim Administrativ Nr. 20/2015 për Kriteret për Zonat për Larje;

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është vendosja e nje kuadri normative për monitorimin dhe klasifikimin e ujërave për larje, menaxhimin e cilësisë së ujërave për larje, si dhe informimin e publikut lidhur me cilësinë e ujërave për larje.

Ky udhëzim administrativ është në përputhshmëri me Direktivën për Menaxhimin e Cilësisë së Ujërave (Direktiva 2006/7/EC).

Udhëzim Administrativ Nr. 12/2015 për Përcaktimin e Kriereve për Zonat e Mbrojtura për Qëllime Strategjike;

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kriteret dhe çështjet tjera për shpalljen e zonave të mbrojtura ujore për qëllime strategjike.

Udhëzim Administrativ Nr. 19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave;

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i përmbajtjes së programit të masave që duhet të ndërmerren për parandalimin dhe mbrotjen nga veprimet e dëmshme të ujërave si dhe përcaktimi i mënyrës, procedurave dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave. Ky udhëzim administrativ është në përputhshmëri me Direktivën për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet (Direktiva 2007/60/EC).

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 për Strukturën e Pagesave të Ujit;

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e kompensimit për shfrytëzimin e ujërave, shkarkimin e ujërave të ndotura dhe kompensimi për nxjerrjen e inerteve nga shtretërit dhe brigjet e ujërrjedhave.

Udhëzim Administrativ Nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore;

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e statusit të pasurisë ujore përfshirë mënyrën e shfrytëzimit të saj si dhe kushtet e shpalljes së një pasurie ujore si pasuri ujore publike si dhe kushtet e ndërprerjes së statusit të një pasurie ujore publike.

Rregullorja 02/2016 për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike;

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të rregullojë mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike për një trup uJOR sipërfaqësor, si dhe metodologjinë, punët hulumtuese dhe procedurat që duhet të zbatohen për përcaktimin e prurjes së pranueshme ekologjike duke marrë parasysh veçoritë e ekosistemit lokal dhe variacionet sezonale të prurjes.

Udhëzim Administrativ Nr. 11/2016 për Përcaktimin e Masave dhe Veprimeve për Mbrojtje nga Erozioni;

Ky Udhëzim Administrativ përcakton mënyrën e shpalljes së zonave erozive dhe procedurave për mbrojtjen e tyre si dhe masave që ndërmerren për planifikimin, organizimin, dhe parandalimin e erozionit.

Udhëzim Administrativ Nr. 04-2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujë rrjedhave dhe Akumulacioneve.

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave në bazë të cilave mund të kryhet ndërrimi i drejtimit të ujërrjedhave, nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurëve, si dhe ndërtimi i objekteve në brigjet e ujërrjedhave dhe akumulacioneve me qëllim të mbrojtjes së stabilitetit të objekteve mbrojtëse dhe rrjedhimisht të mbrojtjes nga efektet e dëmshme të ujërave.

Udhëzim Administrativ Nr. 09-2016 për Strukturën Organizative dhe Detyrat Shtesë të Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të përcaktohen, detyrat, përgjegjësitë, si dhe struktura organizative e Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore (në tekstin e mëtutjeshëm, ARPL).

Udhëzim Administrativ Nr. 09-2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është krijimi i kuadrit normativ që rregullon projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave.

Përvoja ne shtetet tjera

Kroacia

Themel i menaxhimit te integruar te sektorit te ujërave ne republikën e Kroacisë (e cila është anëtare i BE-se) janë dy ligje, Ligji i Ujërave dhe Ligji i Financimit te Resurseve Ujore. Gjithashtu ne menaxhimin direkt të resurseve ujore janë te nxjerra nga Ligji mbi 30 udhëzime administrative. Me Ligjin e Ujërave, i cili është aprovuar ne vitin 2009 rregullohet statusi juridik i ujërave, pasurive ujore dhe objekteve ujore, administrimi me kuantitetin dhe kualitetin e ujërave, mbrojtja nga veprimet e dëmshme te ujërave, ujitja dhe kullimi i ujërave, **veprimtaria e furnizimit publik dhe kanalizimit**, veprimtaritë e posaçme për nevoja të administrimit te ujërave, *strukturën institucionale* te kryerjes se këtyre aktiviteteve dhe çështjet tjera lidhur me ujera dhe pasuri ujore. Sipas Ligjit ne fjale uji nuk është produkt komercial si çdo produkt tjetër,por është një trashëgimi qe duhet ruajtur, mbrojtur dhe me mençuri e racioniletitet shfrytëzuar. Qellim i menaxhimit te resurseve ujore sipas Ligjit është:

1. Sigurimi i sasive te mjaftueshme te ujit te cilësisë për pije për furnizim te popullsisë;
2. Sigurimi i sasive te mjaftueshme te ujit te kualitetit te caktuar për nevoja te ekonomisë dhe atyre te posaçme.
3. Mbrojtja e njerëzve dhe pasurive te tyre nga vërshimet dhe veprimeve te tjera te dëmshme ujore.
4. Arritja dhe ruajtja e gjendjes se mire te ujërave për shkak te mbrojtjes se jetës dhe shëndetit të njeriut, mbrojtjes se pasurisë se tyre, mbrojtja e ekosistemeve ujore .

Sipas ligjit të Ujërave Kroacia menaxhohet ne dy Distrikte Ujore: Distrikti i Lumit Danub dhe Distrikti i Adriatikut.

Zbatimi i politika të ujërave ne Kroaci bazohet nde dokumentet planifikuese vijuese:

- Strategjia e administrimit te ujërave;
- Plani i menaxhimit te distrikteve ujore;
- Programi shumëvjeçar i ndërtimit;
- Plani financiar i administrimit te ujerave, dhe
- Programi i Masave.

Zbatimi i dokumenteve te planifikimit realizohet përmes instrumenteve vijuese administrative-Akteve ujore:

1. Kushtet Ujore;
2. Mendimi i obliguar i te drejtës ujore
3. Vërtetimi uxor
4. Leja Ujore
5. Kushtet e posaçme te kyçjes
6. Vërtetimi mbi pajtueshmërinë me kushtet e veçanta te kyçjes;

Zyrtaret e autorizuar për lëshimin e akteve ujore janë të obliguar të kenë përgatitjen profesionale dhe provimin profesional (shtetëror) (neni 141). Gjithashtu dhe zyrtaret të cilët ushtrojnë detyrat e inspektorit të ujerave duhet të kenë të dhëne provimin profesional shtetëror.

Menaxhimi i strukturës institucionale të resurseve ujore në Kroaci është si në vijim:

- Këshilli Nacional i Ujerave të Kroacisë që është organ i pavarur dhe i përgjigjet parlamentit;
- Qeveria e Kroacisë
- Ministria e Bujqësisë në kuadër të çiles ka sektorë të posaçme të resurseve ujore
- Ujërat e Kroacisë-autoritete të pavarura që disponon Statutin e punës sipas Ligjit të ujerave

Federate e Bosnes dhe Hercegovinës

Menaxhimi i resurseve ujore në Federatën e Bosnes dhe Hercegovinës bazohet në Ligjin e Ujerave. Qëllimet dhe parimet e menaxhimit të integruar të resurseve ujore janë pothuajse analoge me ato të theksuara në Ligjin e Ujerave të Kroacisë.

Gjithashtu edhe Federata e Bosne-Hecegovinës është e ndarë në dy distrikte në kuadër të menaxhimit të resurseve ujore: Distrikti Sava dhe Distrikti Detit Adriatik

Në aspektin e planifikimit të resurseve ujore, sipas këtij ligji përcaktohen këto dokumente planifikuese:

- Strategjia e Ujerave, dhe
- Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Ujore
- Programi i masave

Ligji i ujerave përcakton zbatimin e ligjit, respektivisht dokumenteve planifikuese përmes këtyre instrumenteve administrative-Akteve Ujore:

- Pëlqimi paraprak ujor;
- Pëlqimi ujor;
- Leja ujore

Në kuadër të menaxhimit të ujerave, respektivisht dy distrikte janë organizuar edhe dy autoritete të pavarura dhe ato janë:

- Agjencia për menaxhimi të ujerave Sava
- Agjencia për menaxhimi të ujerave Adriatiku

Në kuadër të dy distrikte të menaxhimit të resurseve ujore organizohen edhe Këshillat e Ujerave:

Mali i Zi

Themel i menaxhimit te integruar te sektorit te ujerave ne republikën e Malit te Zi (e cila është janë dy ligje, Ligji i Ujërave dhe Ligji i Financimit te Resurseve Ujore. Gjithashtu ne menaxhimin direkt te resurseve ujore janë te nxjerra nga Ligji mbi 30 udhëzime administrative.

Qëllimet dhe parimet e menaxhimit te integruar te resurseve ujore janë pothuajse analoge me ato te theksuara ne Ligjin e Ujërave te Kroacisë.

Ne aspektin e planifikimit te resursev ujore,sipas këtij ligji përcaktohen këto dokumente planifikuese:

- Baza e Ujërave te Republikës , dhe
- Plani i Menaxhimit te Pellgjeve Ujore
- Programi i masave

Ne kuadër te menaxhimit te ujerave,respektivisht dy distrikte jane organizuar edhe dya autoritete te pavarura dhe ato janë:

- Regioni për menaxhimi e ujerave Sava
- Agjencia për menaxhimi e ujerave Adriatiku

Ligji i ujerave përcakton zbatimin e ligjit,respektivisht dokumenteve planifikuese përmes këtyre instrumenteve administrative-Akteve Ujore:

- Kushtet Ujore;
- Pëlqimi ujqor;
- Leja ujore
- Urdhëresa Ujore

Menaxhimi i resurseve ujore është i organizuar ne kuadër te Ministrisë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ne kuadër te se cile janë dy drejtoritë menaxhues:

1. Drejtorati i Sektorit të Ujërave
2. Administrimi i Ujërave

Synimet dhe Objektivat

Synimet

Qëllimi i hartimit të Koncept-Dokumentit për përmirsimin e politikave në fushen e ujerave janë si në vijim:

- Përafrimi i legjislacionit vendor për mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve ujore me legjislacionin e BE-së.,

- Ngritja e kapaciteteve institucionale në harmoni me direktivave të BE-së në fushën e ujërave.
- Tranzicioni drejt standardeve dhe normave më të avancuara të cilësisë së ujërave.

Objektivat

- Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së.,
- Zbatimi efektiv i legjislacionit,
- Sigurimi i kornizës së mbrojtjes së cilësisë së ujit dhe arritja e “statusit të mirë të ujit” siç kërkohet me Direktivën kornizë të Ujërave.

Opsionet

Opsioni i Parë – Asnjë ndryshim ligjor nuk kërkohet (Status quo)

Miratimi i Opsionit të parë rezulton në një mospërafrim me acquinë e BE-së, mos pëmbushje të obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe zbatimi jo efektiv i legjislacionit në fushën e ujërave.

Opsioni i Dytë – Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës

Miratimi i Opsionit të dytë rezulton në:

1. Transpozimi i mëtutjeshëm i direktivave europiane në fushën e ujërave,
2. Plotësimi dhe ndryshimi në kornizën ligjore aktuale,
3. Zbatimi efektiv i legjislacionit,
4. Rirregullimin e strukturave institucionale në administrimin e resurseve ujore, si dhe përmirësimi i dispozitave të legjislacionit në aspektin e së drejtës ujore,
5. Ngritja e kapaciteteve institucionale,
6. Definimi i dispozitave lidhur me çështjet e regjistrimit dhe administrimit të pronave ujore dhe bartjet e tyre.
7. Definimi i metodologjisë së përlllogaritjes të obligimeve financiare të operatorëve të cilët shfrytëzojnë dhe shkarkojnë ujërat.

Opsioni i Tretë – Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Miratimi i Opsionit të tretë rezulton në:

- Transpozimin e nivelit të ulët i direktives kornizë të ujërave që ndikon në mungesë të përafrimit të legjislacionit dhe mos përmirësimit të obligimeve nga MSA,

- Mos evitimin e pengesave të identifikuara në zbatim,
- Shfaqjen e pengesave të reja,

Kapitulli V - Përmbledhje e Opsioneve

SUMMARY OF OPTIONS			
Karakteristikat kryesore	OPSIONI I	OPSIONI II	OPSIONI III
Karakteristikat kryesore të opsioneve	Asnjë ndryshim	Përafrimi i mëtej me legjislacionin e BE-së dhe eliminimi i pengesave në zbatim të legjislacionit	Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit të ujërave
Popullsia e synuar / sektorët / rajonet e prekura	I gjithë vendi / shfrytëzim i resurseve ujore, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtja e ujërave	I gjithë vendi / shfrytëzim i resurseve ujore, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtja e ujërave	I gjithë vendi / shfrytëzim i resurseve ujore, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtja e ujërave
Karakteristikat e zbatimit / kush është përgjegjës - Qeveria (kush), sektorët privatë	MMPH, MZHE, MBPZHR, MPB, MF, ZKM, MFSK, AKI, MD, MSH, MPJ, MPMS, PZHKP/UNDP Kryqi i kuq i Kosovës, Komunitat, Operatorët, Inspektorët e Mjedisit dhe ujërave	MMPH, MZHE, MBPZHR, MPB, MF, ZKM, MFSK, AKI, MD, MSH, MPJ, MPMS, PZHKP/UNDP Kryqi i kuq i Kosovës, Komunitat, Operatorët, Inspektorët e Mjedisit dhe ujërave	MMPH, MZHE, MBPZHR, MPB, MF, ZKM, MFSK, AKI, MD, MSH, MPJ, MPMS, PZHKP/UNDP Kryqi i kuq i Kosovës, Komunitat, Operatorët, Inspektorët e Mjedisit dhe ujërave
Administrimi i programeve, shërbimeve ose shpërndarja	MMPH, MZHE, MBPZHR, MF, MPB	MMPH, MZHE, MBPZHR, MF, MPB	MMPH, MZHE, MBPZHR, MF, MPB

SUMMARY OF OPTIONS			
Karakteristikat kryesore	OPSIONI I	OPSIONI II	OPSIONI III
Ligji, ndryshimi i ligjit, zbatimi, sanksionet	Asnjë ndryshim ligjor nuk është parashikuar	Nevoja për ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar	Nuk janë të miratuara të gjithë UA që dalin nga ligji i ujërave
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat	Shumë aktivitete janë subjekt i legjislacionit të ujërave. Arkëtim i të hyrave nga shfrytëzimi i ujërave, shkarkimi i ujërave të ndotura dhe eksploatimi i inerteve	Ngritja substanciale e inkasimit të taksave nga resurset ujore.	Ngritja e nivelit të inkasimit.
Fushata për edukim dhe komunikim	Komunikimi dhe takimet me palët e interesit	Mbajtja e fushatave të vetdisimit. Komunikimi dhe takimet me palët e interesit	Përfshirja më e madhe e publikut në proceset e zbatimit të legjislacionit.
Udhëzimet dhe kodet	Legjislacioni ekzistues	Plotësim ndryshimi i legjislacionit ekzistues.	Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues.
Koha kur do të hyjë në fuqi opsioni	Është në fuqi	Hyrja në fuqi K4/2018	Hyrja në fuqi K1/2018

Kapitulli VI - Analiza e Opsioneve

Përfitimet

Përfitimet për opsionin 1: NUK JANË KËRKUAR NDRYSHIME LIGJORE (Status quo)

Miratimi i opsionit 1 nuk do të kërkoj ndryshim ligjor, duke shmangur çdo ndikim në ngarkesën e punës së institucioneve kompetente, nuk sjell përfitime shtesë.

Mungesa e shpenzimeve në procesin e ndryshimit të legjislacionit

Përfitimet për opsionin 2: Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës

Me opsionin e dytë arrihen : transpozimi i mëtutjeshëm i direktivave europiane në fushën e ujërave, plotësimi dhe ndryshimi në kornizën ligjore aktuale, zbatimi efektiv i legjislacionit, rirregullimi i strukturave institucionale në administrimin e resurseve ujore, si dhe përmirësimi i dispozitave të legjislacionit në aspektin e së drejtës ujore. Ngritja e kapaciteteve institucionale, definimi i dispozitave lidhur me çështjet e regjistrimit dhe administrimit të pronave ujore dhe bartjet e tyre, definimi i metodologjisë së përlllogaritjes të obligimeve financiare të operatorëve të cilët shfrytëzojnë dhe shkarkojnë ujërat.

Përfitimet për opsionin 3: – Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Miratimi i Opsionit të tretë rezulton në: eliminimin e disa pengesave në nivelin e zbatimit të legjislacionit ekzistues.

Kosto

<i>Kategoria e shpenzimeve</i>	<i>Shpenzimet aktuale të vitit paraprak</i>	<i>Buxheti këtë vit</i>	<i>MTEF për vitin e ardhshëm</i>
<i>Buxheti i Ministrisë (Listoni çdo lloj shpenzimi) P&M – Pagat dhe mëditjet M&Sh – Mallrat dhe shërbimet IK – Investimet Kapitale</i>	<u>36,158,396.68</u>	<u>49,121,434.00</u>	<u>48,557,601.00</u>
<i>Buxhetet tjera</i>			

<i>(Listoni çdo lloj shpenzimi)</i>			
<i>Financimi i donatorëve</i>	<i>1,294,548.53</i>	<i>1,617,977.50</i>	
<i>Shpenzimet e drejtpërdrejta të Ministrisë së Financave</i>			

Pasojat negative

Opsioni 1:

Miratimi i Opsionit të parë rezultonë në një mospërafrim me acquinë e BE-së, mos pëmbushje të obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe zbatimi jo efektiv i legjislacionit në fushën e ujërave.

Opsioni 2:

Koha e nevojshme për procesin e ndryshimit të legjislacionit të ri si dhe ngritja e shpenzimeve shtesë për shkak të rritjes së kapaciteteve në administrimit e resurseve ujore është e domosdoshme për arritjen e administrimit më të mirë të resurseve ujore

Opsioni 3:

Niveli i ulët i transpozimit të acquis së BE-së dhe pengesa në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit fiskal				
	(000s Euros)			
	Viti aktual	VITI 1	VITI 2	VITI 3
OPSIONI 1				
Ndryshimi neto në alokimin e shpenzimeve		0	0	0
Ndryshimi neto në gjenerimin e të ardhurave		124,346	124,346	124,346
Financimi i pritshëm i donatorëve		0	0	0
OPSIONI 2				
Ndryshimi neto në alokimin e shpenzimeve		0	0	0
Ndryshimi neto në gjenerimin e të ardhurave		124,346	124,346	124,346
Financimi i pritshëm i donatorëve		0	0	0
OPSIONI 3				
Ndryshimi neto në alokimin e shpenzimeve		0	0	0
Ndryshimi neto në gjenerimin e të ardhurave		124,346	124,346	124,346
Financimi i pritshëm i donatorëve		0	0	0

KAPITULLI VII– Konsultimet

Procesi i konsultimit për zhvillimin e këtij Koncept dokumenti :

Konsultimi i brendshëm në MMPH dhe

Konsultimit përfshiu grupe të ndryshme të palëve të interesuara si:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Ministria e Shëndetësisë / IKSHPK

Zyra e Kryeministrit

Ministria e Integritit Evropian (MEI)

AME/MPB

MF

OJQ

Kapitulli VIII - Krahasimi i Opsioneve

Opsioni 1:

Përfitimet kryesore që lidhen me opsionin 1 janë:

Miratimi i opsionit 1 nuk do të kërkoj ndryshim ligjor, duke shmangur çdo ndikim në ngarkesën e punës së institucioneve kompetente, nuk sjell përfitime shtesë

Mungesa e shpenzimeve në procesin e ndryshimit të legjislacionit

Aspektet negative janë:

Miratimi i Opsionit të parë rezulton në një mos për afrim me *acquis* të BE-së, mos përmbushje të obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe zbatimi jo efektiv i legjislacionit në fushën e ujërave.

Opsioni 2:

Përfitimet kryesore që lidhen me opsionin 2 janë:

transpozimi i mëtutjeshëm i direktivave evropiane në fushën e ujërave, plotësimi dhe ndryshimi në kornizën ligjore aktuale, zbatimi efektiv i legjislacionit, rirregullimin e strukturave institucionale në administrimin e resurseve ujore, si dhe përmirësimi i dispozitave të legjislacionit në aspektin e së drejtës ujore .

ngritja e kapaciteteve institucionale, definimi i dispozitave lidhur me çështjet e regjistrimit dhe administrimit të pronave ujore dhe bartjet e tyre, definimi i metodologjisë së përlllogaritjes të obligimeve financiare të operatorëve të cilët shfrytëzojnë dhe shkarkojnë ujërat.

Aspektet negative janë:

Koha e nevojshme për procesin e ndryshimit të legjislacionit të ri si dhe ngritja e shpenzimeve shtesë për shkak të rritjes së kapaciteteve në menaxhimin e resurseve ujore është e domosdoshme për arritjen e menaxhimit më të mirë të resurseve ujore.

Opsioni 3:

Përfitimet kryesore që lidhen me opsionin 3 janë:

Miratimi i Opsionit të tretë rezulton në: eliminimin e disa pengesave në nivelin e zbatimit të legjislacionit ekzistues.

Aspektet negative janë:

Niveli i ulët i transpozimit të *acquis* së BE-së dhe pengesa në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Shqyrtimi i zbatimit

Zhvillimi i Opsionit 2 rezulton të ketë ndikim pozitiv në statusin e mjedisit dhe shëndetit dhe në sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve ujore.

Përtej vlerësimit të kryer Opsioni nr. 2 duket të jetë opsioni i preferuar për të përmirësuar sistemin e menagjimit të resurseve ujore.

Opsioni 2 është harmonizimi i legjislacionit ekzistues të ujërave dhe po siguron transpozimin e kuadrit ligjor të BE-së në sistemin kombëtar.

Kapitulli IX - Rekomandimi

Opsion më i favorshëm për rekomandim konsiderohet opsioni 2, ku mundësohet të arrihen synimet dhe objektivat në fushën e administrimit e resurseve ujore.

Kapitulli X - Komunikimi

Komunikimi lidhur me ndryshimet e propozuara planifikohet pas ndryshimit dhe aprovimit të tij. Planifikohen aktivitete të promovimit të Ligjit nëpër komuna, takime me qytetarë, promovimit në media dhe broshura. Ministria do të komunikojë me nivelin qendror dhe lokal. Do të bëhen shpallje publike nëpër komuna për të informuar popullatën nën juridiksionin e tyre. Komunikimi do të bëhet menjëherë pas aprovimit të Ligjit duke e promovuar nëpër komuna.